



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA


VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
DHE ËSHTË I PRAVNOBËSHTETËS
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Numri i lëndës: 2018:015798

Datë: 04.06.2018

Numri i dokumentit: 00053107

P.nr.2535/17



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] të gjithë nga Ferizaj, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.463-2/16 të dt. 05.10.2017, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar dhe publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, si dhe të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] më datë 15.05.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë aktgjykimin, ndërsa me datë 21.05.2018 përpiloi këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] i lindur me [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka të kryer shkollën e mesme, me profesion mekanik, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të letërnjoftimit [REDACTED]

I pandehuri: [REDAKTUAR] i lindur me [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të letërnjoftimit [REDAKTUAR]

I pandehuri: [REDAKTUAR] i lindur me [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të letërnjoftimit [REDAKTUAR]

JANË FAJTOR

Sepse:

Me datë 08.01.2016, rreth orës 12.00, në rrugën “Wesli Clark”, në Ferizaj, përkatësisht në lokalet e kafiterisë “Mambo”, pas mosmarrëveshjeve të mëparshme që kishte pasur i dëmtuari [REDAKTUAR] me një shokë të të pandehurve - [REDAKTUAR] i therrur me thikë, të pandehurit, posa e takojnë të dëmtuarin e godasin me grushte dhe shkelma në pjesë të ndryshme të trupit, pra me dashje kanë përdorur në bashkëkryerje forcën ndaj të dëmtuarit pa pëlqimin e tij.

me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,49,50,51,52,73 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurin [REDAKTUAR] me dënim me gjobë në lartësi prej 300 Euro /treqind/, të cilin dënim duhet ta paguaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë në afat prej 30 ditësh nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Të pandehurin [REDAKTUAR] me dënim me gjobë në lartësi prej 300 Euro /treqind/, të cilin dënim duhet ta paguaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë në afat prej 30 ditësh nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Të pandehurin [REDAKTUAR] me dënim me gjobë në lartësi prej 300 Euro /treqind/, të cilin dënim duhet ta paguaj pas aktgjykimi të merr formën e prerë në afat prej 30 ditësh nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë dënimin brenda afatit prej 30 vetëve, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'iu a zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ /njëzetë euro/, të papaguara do t'i llogaritet 1 /një/ ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50 Euro /pesëdhjetë/, në mënyrë solidarë, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Detyrohen të akuzuarit që për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajnë shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, në mënyrë solidarë, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën janë proceduar të pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.463-2/16 dt.05.10.2017 ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të gjithë nga Ferizaj, për veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurit të shpallen fajtor dhe t'iu shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 15.05.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari [REDAKTUAR] e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë veprë penale, i premtun gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritet dhe se është hera e parë që bije ndesh me ligjin, si dhe të dëmtuarit i ka kërkuar falje dhe është pajtuar me të dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë, ndërsa i akuzuari [REDAKTUAR] e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë veprë penale, i premtun gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritet dhe se është hera e parë që bije ndesh me ligjin, si dhe të dëmtuarit i ka kërkuar falje dhe është pajtuar me të dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë, s dhe i akuzuari [REDAKTUAR] sikurse dy të akuzuarit e sipër cekur e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë veprë penale, i premtun gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritet dhe se është hera e parë që bije ndesh me ligjin, si dhe të dëmtuarit i ka kërkuar falje dhe është pajtuar me të dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë.*

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu duke shprehur mendimin e tij përkritazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurve, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe t'iu shqipton dënimin e merituar.

Me që të pandehurit e kanë pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban

aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt.21.01.2016, raporti i oficerit dt.22.01.2016, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt. 18.02.2018, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt.03.03.2016, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt. 01.03.2016, deklarata e dëshmitarit [REDAKTUAR] e dt.23.02.2016 si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga interpretimi dispozitës të nenin 188 arrihet në përfundimin se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik, të personit, cenimi i të cilit pas sjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si veprë penale nga ligji, duhet që të kenë prekur shëndetin e personit, konkretisht funksionimin normal të trupit të të dëmtuarit, duke i sjelle atij paaftësi të përkohshme. Në rastin konkret veprimet e dhunës duhet të sjellin si pasojë cënimin e integritetit fizik, psikosocial e ekonomik, rrethanë kjo cilësuese e veprës penale. Me integritet fizik do të kuptohet e drejta dhe mundësia që ka një person për të zotëruar dhe kontrolluar vetë trupin e tij dhe për t'u ndier i sigurt nga çdo formë e dhunës.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar kanë pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale

të kryer, janë të gjendjes së dobët ekonomike, ka qenë hera e parë që kanë ra ndesh me ligjin, si dhe që të gjithë i kanë kërkuar falje të dëmtuarit dhe janë pajtuar me të, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurve i'u shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjeneralë, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurve.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.


Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.2535/17 datë 21.05.2018.

Zyrtare ligjore,
Kadisha Shabani

Gjyqtari: **Ilir BYTYQI**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.